



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 176 prot.

Tiranë, më 30 . 01 . 2024

**V E N D I M**

**Nr. 28 , datë 30 . 01 . 2024**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup> mori në shqyrtim ankesën me nr. 192 Regj., datë 27.09.2023, paraqitur nga z. A. H<sup>3</sup> kundër Bashkisë Maliq, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar dhe vendbanimit.<sup>4</sup>”

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, z. A. H, në mes të tjerash informon Komisionerin, se: “Jam banues në fshatin Bregas, Njësia Administrative Vreshtas e Bashkisë Maliq. Gëzoj statusin e të verbërit, dhe kam një problematikë të cilën e konsideroj diskriminuese. Njëri prej fëmijëve, ndjek mësimet në Shkollën e Mesme Profesionale të Ndërtimit në Korçë dhe largësia nga banesa ime tek shkolla e djalit është mbi 20 km. Djali im shkon çdo ditë në shkollë me anë të transportit publik, dhe lidhur me tarifën e transportit duhet të rimbursohet nga Bashkia, pasi ai është përfitues, pasi unë jam kryefamiljari dhe jam me aftësi të kufizuar, dhe po ashtu edhe për shkak se vendbanimi është 20 km nga shkolla ku djali ndjek procesin mësimor. Nuk kam të

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

<sup>3</sup> Si përfaqësues ligjor i të birit O. H (referuar gjeneraliteteve, i biri rezulton minorene, pasi ka datëlindjen 17.11.2006)

<sup>4</sup> Referuar vërtetimit me nr. 837 prot., datë 25.07.2023, të lëshuar nga Njësia Administrative Vreshtas/Bashkia Maliq, rezulton se z. A. H, është banor i fshatit Bregas, dhe trajtohet me pagesën e verbërisë (posedon Statusin e të Verbërit)

*ardhura të mjaftueshme financiare që të përballoj transportin e fëmijës dhe kjo gjë do më bëjë që të heq fëmijën nga shkolla dhe ta privoj atë nga e drejta e arsimimit.”*

Subjekti ankues, ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe përfshirjen e emrit të të birit në listën e hartuar nga Bashkia, për marrjen e rimbursimit të transportit, përfitimin e pagesës, pasi ai ndjek mësimet në klasën e 11-të, në Shkollën e Mesme të Ndërtimit, në degën “Termohidraulikë”, Korçë, ndërsa vendbanimin e ka në fashatin Bregas/Bashkia Maliq.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh. Në nenin 1 të LMD parashikohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”*

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se:

*“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato*

*a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;*

*b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.*

*2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: ...*

*c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun...”*

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj. Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

1. Me shkresën nr. 1051/1, datë 05.10.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga Bashkia Maliq, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
  - Parashtrime lidhur me pretendimet e subjektit ankues.
  - Informacion mbi arsyet se përse fëmija i subjektit ankues nuk e përfiton falas apo me rimbursim, transportin publik me qëllim ndjekjen e procesit mësimor në Shkollën e Mesme të Ndërtimit, Korçë, për vitin shkollor 2023-2024.
  - Informacion nëse e ka përfituar këtë rimbursim pagese të transportit publik, për vitin shkollor paraardhës 2022-2023. Nëse po, ju lutem kopje të akteve provuese.
  - Informacion, parashtrime lidhur me masat konkrete të ndërmarra apo që do ndërmerren nga ana e Bashkisë Maliq për zgjidhjen e kësaj problematike, të fëmijës së ankuesit.
  - Informacion dhe statistika nëse disponohen, lidhur me numrin e nxënësve përfitues, pjesë e listave të përfituesve të Bashkisë Maliq, (sipas kategorive përkatëse), bazuar në VKM nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar.
  - Si dhe çdo informacion tjetër që gjykohet i arsyeshëm dhe se do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.
  
- Me shkresën nr. 5326/1 prot, datë 11.10.2023, Bashkia Maliq, ndër të tjera, informoi Komisionerin se:

*“Në përgjigje të shkresës suaj, lidhur me rastin e z. H, ju bëjmë me dije se sipas VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, për caktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në*

*institucionet arsimore publike”, të ndryshuar, fëmija i tij, O. H, ka përfitur bursë për vitin shkollor 2022-2023, sipas Vendimit nr. 110, datë 19.12.2022, të Këshillit Bashkiak.*

*Duke parë kushtet social-ekonomike të familjes, rasti i tij do të merret në shqyrtim (duke plotësuar dokumentacionin e n evojshtëm nga ana e familjes) për përfitim e bursës për vitin shkollor 2023-2024.*

*Bashkëlidhur parashtrimeve janë depozituar kopje të vendimit nr. 110, datë 19.12.2022, dhe vendimit nr. 111, datë 19.12.2022, të Këshillit Bashkiak Maliq, me listat emërore të nxënësve përfitues për trajtimin me bursë të plotë për arsimin e mesëm.”*

2. Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 1051/3, datë 06.12.2023 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 18.12.2023, ora 12:00, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces, si dhe kërkoi informacion nëse deri aktualisht ka ndonjë masë konkrete të ndërmarrë nga Bashkia për zgjidhjen e problematikës së këtij nxënësi. Nëse po, kopje të akteve provuese.
3. Në seancën e datës 18.12.2023, nuk u paraqitën asnjëra nga palët. Para zhvillimit të seancës, Bashkia Maliq, nëpërmjet e-mailit datë 15.12. 2023, njoftoi Komisionerin se, për arsye objektive nuk mund të ishin të pranishëm në seancë, duke informuar ndër të tjera se:  
*“...ju bëjmë me dije se, fëmija O. H ka përfitur bursë për vitin shkollor 2022-2023, sipas VKB Maliq. Përsa i përket përfitimit të bursës për vitin shkollor 2023-2024, fëmija e përfiton automatikisht duke u rikonfirmuar kushtet social-ekonomike të familjes me vendimin e Këshillit Bashkiak Maliq, të muajit Dhjetor 2023. Bashkia Maliq konfirmon dhe miraton listën me emrat përfitues, sipas kriteve dhe numrit të kuotave të çelura nga MFE, në numrin e llogarisë së çdo nxënësi përfitues. Sapo të kalojë në Këshill vendimi përkatës do jua përcjellim me e-mail.”*
4. Në vijim të sa më sipër, subjekti ankues, nëpërmjet kërkesës datë 19.01.2024<sup>5</sup>, ka falenderuar Komisionerin për angazhimin e tij dhe ka paraqitur kërkesë për tërheqje nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës pranë KMD-së, duke cituar ndër të tjera se:  
*“Deklaroj se heq dorë nga ankesa ime pranë Komisionerit, pasi u njoftova nga Bashkia Maliq për përfitim e bursës së djalit tim O. H, për vitin shkollor 2023-2024. Vlerësoj dhe e konsideroj të zgjidhur problematikën time nga ana e Bashkisë.”*
5. Në mbështetje të sa më sipër, Bashkia Maliq ka vënë në dispozicion të Komisionerit<sup>6</sup> shkresën me nr. 688 prot., datë 26.12.2023, Vendim i Këshillit Bashkiak me nr. 148, datë 26.12.2023 “Për ndarjen e planit të bursave për arsimin e mesëm profesional të vitit shkollor 2023-2024”.

<sup>5</sup> Depozituar në dosjen e ankuesit, në cilësi prove.

<sup>6</sup> Nëpërmjet e-mailit datë 23.01.2024, depozituar në dosjen e ankuesit, në cilësi prove.

Referuar këtij Vendimi, konstatohet se, në pikën<sup>1</sup>, të tij, me numër rendor 9, është miratuar trajtimi me bursë të plotë për arsimin e mesëm profesional për nxënësin O. H (djali i ankuesit), i cili ndjek studimet në Shkollën Profesionale Teknike Korçë.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Në nenin 94<sup>7</sup>/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

Procedura administrative konkrete pranë Komisionerit, është iniciuar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, shtetasi A. H, i cili, me anë të kërkesës datë 19.01.2024, është tërhequr nga ankesa e tij pranë KMD-së.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, si dhe kërkesën për tërheqje nga ankesa, të paraqitur nga subjekti ankues në datën 19.01.2024, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës me nr. 192 regj., datë 27.09.2023, të paraqitur nga shtetasi A. H, kundër Bashkisë Maliq, nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa dhe nuk identifikohet ndonjë interes publik që do të legjitimonte vazhdimin e procedurës, nga ana e këtij organi publik.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 33, pika 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

---

<sup>7</sup> “Tërheqja e ankesës”.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**V E N D O S I :**

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës me nr. 192 Regj., datë 27.09.2023, paraqitur nga subjekti ankues A. H, kundër Bashkisë Maliq, për shkak se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa pranë KMD-së, duke konsideruar se është arritur efektiviteti për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**